



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.4887/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli, dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.M, nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson B.S, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “.....”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson D.M, avokat nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.357/2013, të datës 10.03.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **05.04.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “.....”, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.357/2013, i datës 10.03.2020, në pikën I të dispozitivit që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit F.M nga Prishtina, për kompensimin e dëmit jo material, në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe kjo çështje gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “.....”, me seli në Prishtinë, që paditësit F.M nga Prishtina, në emër të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e trafikut të datës 07.08.2012, t’ia paguajë shumën prej 12,000.00 €, e cila shumë duhet të paguhet me kamatë vjetore siç e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara pa destinacion të caktuar mbi 12 muaj, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, nga shuma e aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar, **REFUZOHET** si e pathemeltë.

II. REFUZOHEN si të pathemelta ankesa e paditësit F.M nga Prishtina dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “.....”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.357/13, i datës 10.03.2020, në pikën I

të dispozitivit që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadiisë së paditësit F.M për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve trupore-fizike, për frikën e shkaktuar, për shëmtim trupor, si dhe për kompensimin e dëmit material në emër të ndihmës së personit të tretë, ushqimit të përforcuar, shpenzimeve për shërim, si dhe dëmin material në emër të rentës për shkak të fitimit të humbur, përfshirë këtu edhe rentën e caktuar në të ardhmen, në pikën II të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, si dhe pika III e dispozitivit që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadiisë të paditësit përtej shumave të gjykuara në emër të dëmit jo material dhe material, përfshirë këtu edhe atë në emër të rehabilitimit klimaterik, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.357/13, të datës 10.03.2020, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar, pjesërisht si të bazuar kërkesëpadiinë e paditësit F.M nga Prishtina, dhe e detyron të paditurën Kompania e Sigurimeve “.....”, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e datës 07.08.2012, paditësit ti shpërblej si në vijim: për dëmin jo material t’ia paguajë shumat si vijon: për dhimbje trupore-fizike shumë prej 4.500.00 €, për frikën e shkaktuar shumë prej 3.500.00 €, për shëmtim trupor në shkallë të mesme, shumë prej 2,500.00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 20.000.00 €, për dëmin material t’ia paguajë shumat si vijon: për ndihmë të personit të tretë shumë prej 300.00 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 300.00 €, për shpenzime të shërimit shumë prej 54 €, për fitimin e humbur për periudhën e kaluar nga data 07.08.2012 deri më datë 31.01.2020 shumë në lartësi prej 3,248.00 €, për rentën në të ardhmen nga data 01.02.2020 e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, renta mujore të jetë R=109.20 €. Në pikën II të dispozitivit ka detyruar të paditurën, që paditësit shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke zbritur shumë prej 3,000.00 € të cilat paditësi i ka marrë në formë të paradhënies nga e paditura, t’ia paguajë me kamatë vjetore siç e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara pa destinacion të caktuara mbi 12 maj, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit 10.03.2020 e deri në përmbushjen definitive, për dëmin jo material si dhe nga data 31.01.2020 për dëmin material e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 2.318.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit ligjor. Në pikën III të dispozitivit gjykata ka refuzuar pjesën e kërkesëpadiisë përtej shumës së gjykuar edhe atë për dëmin jo material, për dhimbje fizike shumë prej 500 €, për frikën shumë prej 500 €, për shëmtimin trupor 2,500.00 €, ndërsa në emër të dëmit material të rehabilitimit klimaterik në tërësi shuma e kërkuar prej 1,000.00 €, si të pabazuara.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, kanë paraqitur ankesë të dy palët ndërgjyqëse. Paditësi përmes të autorizuarit të tij është ankuar, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sa i përket lartësisë së kompensimit, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së

drejtës materiale sa i përket shpenzimeve të procedurës, duke i propozuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj në kuptim të lartësisë së kompensimit dhe shpenzimeve të procedurës.

Ndërsa, pala e paditur ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës, ndërsa ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që ankesën si të tillë ta aprovoj, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të aprovoj shumë më të ulët në emër të kompensimit të dëmit si satisfacion real ose aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t'a kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Palët ndërgjyqëse nuk kanë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është **e pathemeltë**, ndërsa ankesa e të paditurës është **pjesërisht e themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensim të dëmit material dhe jo material, në shumat e kërkuara (si në padi), për lëndimet e shkaktuara me rastin e aksidentit të ndodhur në komunikacion, të datës 07.08.2012, respektivisht, shumën të cilën paditësi e ka precizuar përmes parashtresës, si dhe kamatën ligjore prej 12 %, duke filluar prej datës 07.08.2012 e deri në plotfuqishmërisë e aktgjyimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit, dhe t'ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës.

Duke vepruar sipas kësaj padie, gjykata e shkallës së parë zhvilloi procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave si: raportin e aksidentit datë 07.08.2012, së bashku me skicën e vendit të ngjarjes, kallximi penal, foto dokumentacioni, raporti i QKUK-së, raporti mjekësor me faturat e shpenzimeve, ekspertiza e komunikacionit, aktgjykimi P.nr.110/13 datë 19.06.2015 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ekspertiza mjekësore datë 16.01.2017, ekspertiza financiare e ekspertes V.V datë 05.02.2020, *(dhe prova të tjera si në shkresat e lëndës)*, në bazë të të cilave gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.357/2013, të datës 10.03.2020, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, mes tjerash, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se baza e kërkesëpadisë është vërtetuar nga provat e administruara, përkatësisht ekspertiza e komunikacionit e hartuar nga grupi i ekspertëve të cilëve gjykata ia fali besimin, andaj gjykata pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat e administruara që i referohen natyrës dhe pasojave të lëndimeve të pësuar nga paditësi si pasoj e aksidentit e duke marrë për bazë mendimin e

ekspertëve mjeko-ligjor lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jo material, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 200 të LMD-së. Në anën tjetër, gjykata vërtetoi gjendjen faktike, me prova materiale e me aplikimin e drejtë të dispozitave ligjore të neneve 154, 178, 200 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensoi shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë vjetore siç e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara pa destinacion të caktuar mbi 12 muaj duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit 10.03.2020 e deri në pagesën definitive, me aplikimi të dispozitave ligjore nga neni 277 par.1 të LMD-së (viti 1978) i cili ishte në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit. Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata i ka bazuar në nenin 449 dhe 452.2 të LPK-së. *(më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar).*

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë, përveç pjesës së ndryshuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për të cilën është ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, për çka edhe ajo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë lidhur me bazën e përgjegjësisë së të paditurës për kompensimin e dëmit (bazën juridike të kërkesëpadisë), i pranon në tërësi Gjykata e Apelit, pasi që me të drejtë vërtetimi i kësaj baze bazohet në provat materiale përkatëse siç janë raporti i policisë, skica në vendin e ngjarjes, kallëzimi penal, ekspertiza e komunikacionit etj, me të cilat provohet fakti se shkaktori i aksidentit të komunikacionit të datës 07.08.2012, është i siguruari i të paditurës, ndërsa si pasojë e tij lëndime të rënda trupore ka pësuar këmbësori-paditësi, i cili ishte duke lëvizur në skaj të rrugës. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret e paditura është përgjegjëse në bazë të auto përgjegjësisë për kompensimin e dëmit jo material dhe material këtu paditësit dhe atë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 154 dhe 178 të LMD-së. Në anën tjetër, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se

shumat e gjykuara janë në kundërshtim me shkallën dhe natyrën e lëndimeve, pasi gjykata në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor të caktuar me vendimin e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, të përbërë prej 3 anëtareve Dr.F.M, Dr.V.K, dhe Dr.N.Sh, ka konstatuar se lëndimet e paditësit janë lëndime të rënda trupore. Ndërsa lartësinë e kompensimit gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur duke pasur parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së dëmit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, e frikës së pësuar, si dhe duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor, të cilave gjykata me të drejtë ia fali besimin. Në lidhje me këtë, edhe gjykata e shkallës së dytë e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizave të grupit të ekspertëve mjekësor që ndërlidhen me natyrën e lëndimeve të paditësit dhe lartësinë e kërkesëpadisë, pasi që është një përfundim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të paditurës për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësit në raport me dëmin jo material për dhimbjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, nga arsyeja se shuma e gjykuar është e lartë dhe nuk i shkon përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Prandaj, në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës, e ndryshoj aktgjykimin e ankimit të gjykatës së shkallës së parë në pikën I të tij dhe gjykoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shuma e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material, përkatësisht për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, është shumë e lartë dhe nuk bazohet në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se tani shuma e gjykuar për paditësit si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi është adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 par.2 të LMD-së, të zbatuar për këtë rast dhe se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që të dëmtuarit (në këtë rast paditësi) t'i përballoj më lehtë dëmet jo materiale dhe materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me nenin 200 par.2 të LMD përcaktohet se *“me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit dhe me dhimbjet fizike të pësuar (në këtë rast sipas ekspertizës mjekësore rezulton se paditësi si pasojë e lëndimeve të rënda trupore ka pasur 28.7 % të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor), ashtu që ky kompensim të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësit i kanë pësuar në aksidentin e komunikacionit, e në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë që është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Si rrjedhojë, shumat e kërkuara

përtej atyre të aprovuara sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, është refuzuar si e pathemeltë.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke i refuzuar si të pathemelta të dy ankesat e palëve ndërgjyqëse, pasi që referuar shkresave të lëndës dhe provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, ka ardhur në përfundim se kjo e fundit drejtë ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit, që ka të bëjë me shumën e aprovuar në emër të dhimbjeve fizike, për frikën e jetuar, për shëmtim trupor, si dëm jo material dhe për dëm material ndihmë personit të tretë, ushqimit të përforcuar, shpenzimet e shërimit, fitimin e humbur, për rentën në të ardhmën si dhe në pikën II të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës. Kjo për faktin se referuar ekspertizës mjekësore të grupit të ekspertëve të cekur më lartë, ka rezultuar se paditësi si pasojë e aksidentit të ndodhur ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit të lartë, frikë sekondare etj, si dhe shëmtim trupor në shallë të mesme, ndërsa shumat e gjykuar, konsiderohen adekuate dhe në përputhje dispoziten e nenit 200.2 të LMD-së dhe me kriteret e zbatuara nga gjykatat e Kosovës. Ndërsa, sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ndihmë personit të tretë, ushqim të përforcuar, e cila po ashtu është vërtetuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, atëherë vërtetohet se të dëmtuarve i takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë. Ndërsa shuma e gjykuar në emër të shpenzimeve të shërimit është bazuar në provat materiale (faturat) e dorëzuara nga pala paditëse.

Në anën tjetër, Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar si të pathemelta ankesat e palëve ndërgjyqëse, pasi ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt dhe ligjshëm ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit, që ka të bëjë me dëmin material për fitimin e humbur si dhe rentën në të ardhmën. Kjo për faktin se referuar ekspertizës mjekësore të dhënë nga eksperti i mjeksisë së punës Dr. Xhevdet Shkodra ka konstatuar se, paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar aftësinë e përkohshme punuese pas aksidentit për periudhën kohore prej 12 muaj pas lëndimit pafatësia për punë 100 %, për vitin pasues e tutje, pafatësia e përhershme është 30 %, andaj gjykata sa i përket lartësisë së dëmit për këto forma të dëmit vendimin e ka mbështetur në ekspertizën financiare e cila drejtë dhe në mënyrë të argumentuar ka caktuar shumat sa i përket dëmit material për fitimin e humbur dhe rentës në të ardhmën, duke marrë për bazë shkallën e invaliditetit të paditësit të përcaktuar me ekspertizë mjekësore si dhe provat materiale të prezantuara nga paditësi se i njëjti nuk posedon kontratë pune, mirëpo ka ofruar provat nga organet administrative, ku i njëjti shihet se është i pa punë, vërtetimin e MPMS Departamenti i Administratës Pensionale dhe Qendra për

Punë Sociale në Prishtinë, ku shihet se paditësi nuk është përfitues i pënsionit për persona me aftësi të kufizuara dhe as i ndihmës sociale. Ndërsa lartësia për këtë formë të dëmit material është provuar nga gjykata e shkallës së parë përmes ekspertizës financiare të ekspertes Vetima Vuçiterna, e cila ekspertizë është e pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë.

Përveç pretendimeve lidhur me shumat më të larta të kërkuara, e të refuzuara si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, palëve ndërgjyqëse i refuzohen edhe pretendimet ankimore lidhur me refuzimin që gjykata e shkallës së parë i ka bërë kërkesës për mbulimin e shpenzimeve për rehabilitim klimaterik. Për këtë formë të dëmit, nuk ka pasur asnjë provë që do të vërtetonte lartësinë e shumës që duhet të kompensohet për të. Andaj, përderisa nuk është respektuar neni 7 i LPK-së, sipas të cilit pala duhet gjithnjë të mbështesë faktet e thëna, me prova konkrete që argumentojnë e vërtetojnë të tillat, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar atë pjesë të kërkesëpadsisë dhe një qëndrim i tillë juridik, vlerësohet i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit.

Me tutje, është vërtetuar edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me shpenzimet procedurale, me të cilin është obliguar pala e paditur si humbëse e kontestit, për kompensimin e shpenzimeve palës paditëse, konform nenit 452 të LPK-së. Gjithashtu si i drejtë vlerësohet edhe vendimi mbi kamatën, të cilën gjykata e shkallës së parë e vendosi konform dispozitave ligjore nga neni 277 par.1 të LMD-së (viti 1978) i cili ishte në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshenga kjo që është vendosur.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit të atakuar, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar. Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat d) dhe e), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4887/2020, datë 28.04.2022

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka